


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Gusht 2025

Tiranë, më 09 Shtator 2025: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Gusht 2025, arriti 119,5, kundrejt muajit Dhjetor 2020.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Gusht 2025 është 2,3 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 2,0 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Gusht 2025, krahasuar me Korrik 2025 është 0,3 %.


Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit. Rritja vjetore e çmimeve në muajin Gusht është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +0,85 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,63 pikë përqindje. Gjithashtu, çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” ndikuan me +0,21 pikë përqindje, çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” me +0,16 pikë përqindje, çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” me +0,14 pikë përqindje, çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” me +0,13 pikë përqindje, çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me +0,07 pikë përqindje, çmimet e grupeve “Transporti” dhe “Komunikimi” me +0,03 pikë përqindje secili, çmimet e grupeve “Veshje dhe këpucë” dhe “Shërbimi arsimor” me +0,02 pikë përqindje secili dhe çmimet e grupit “Shëndeti” me +0,01 pikë përqindje.

Për publikim 09/09/2025

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Gusht 2024, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Argëtim dhe kulturë” me 6,3 %, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 3,3 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 3,1 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 2,8 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2,5 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 2,2 %, “Komunikimi” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 1,2 % secili, “Shërbimi arsimor” me 0,7 %, “Veshje dhe këpucë” me 0,6 %, “Transporti” me 0,5 % dhe “Shëndeti” me 0,4 %.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “Vajra dhe yndyrna” patën një rritje me 6,5 %, pasuar nga nëngrupet “Qumësht, djathë dhe vezë” me 3,6 %, “Mish” me 3,2 %, “Peshk” me 2,4 %, “Fruta” me 2,1 %, “Zarzavate përfshirë patatet” me 1,3 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Korrik 2025, çmimet e grupeve “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”, “Argëtim dhe kulturë” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” shënuan rritje me 0,5 % secili, pasuar nga grupet “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0,4 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike”, “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Veshje dhe këpucë” me 0,3 % secili, “Transporti” me 0,2 %, “Shëndeti”, “Komunikimi” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,1 % secili.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2020=100

Kodi	Grupet	Peshat	08-24	09-24	10-24	11-24	12-24	01-25	02-25	03-25	04-25	05-25	06-25	07-25	08-25
	Gjithsej	100	116,8	117,5	117,6	117,6	118,3	118,7	119,1	119,7	119,8	119,5	119,2	119,1	119,5
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	34,3	130,3	132,1	132,6	132,2	133,4	134,7	135,9	137,4	137,4	135,7	134,5	133,1	133,5
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,9	114,7	114,8	115,2	115,4	116,7	116,9	117,6	117,8	117,9	117,9	117,9	118,1	118,5
3	Veshje dhe këpucë	3,9	110,8	111,4	111,8	112,5	112,9	112,5	111,9	112,0	111,9	111,9	111,6	111,1	111,5
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,1	108,1	108,2	108,0	108,3	108,5	108,4	108,1	108,6	108,8	109,4	109,7	111,0	111,5
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,5	115,5	116,0	116,1	116,3	117,4	117,8	118,0	117,9	117,9	118,4	118,5	118,2	118,7
6	Shëndeti	3,5	104,1	104,1	104,3	104,2	104,4	104,4	104,6	104,6	104,5	104,6	104,6	104,4	104,6
7	Transporti	6,1	109,3	109,2	108,6	108,0	108,7	108,7	108,8	108,9	108,9	109,2	109,5	109,6	109,8
8	Komunikimi	3,0	105,6	105,8	105,8	105,8	106,2	106,2	106,2	106,4	106,5	106,7	106,7	106,7	106,8
9	Argëtim dhe kulturë	2,3	115,3	117,5	117,9	117,7	117,5	117,8	118,8	120,3	120,3	121,0	121,6	122,0	122,6
10	Shërbimi arsimor	3,4	105,4	105,8	105,9	106,0	106,0	106,1	106,1	106,1	106,1	106,1	106,1	106,1	106,1
11	Hotele, kafene dhe restorante	5,7	115,0	115,0	115,3	115,3	115,6	115,6	115,8	115,9	116,0	116,1	116,2	117,0	117,6
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,6	107,8	107,9	107,9	108,1	108,2	108,5	108,7	108,7	108,8	108,7	108,8	108,9	109,1

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	08-24/08-23	09-24/09-23	10-24/10-23	11-24/11-23	12-24/12-23	01-25/01-24	02-25/02-24	03-25/03-24	04-25/04-24	05-25/05-24	06-25/06-24	07-25/07-24	08-25/08-24
	Gjithsej	2,0	1,9	1,9	2,0	2,1	1,9	1,9	2,1	2,3	2,2	2,4	2,5	2,3
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,4	2,7	3,1	3,2	3,0	2,6	2,8	3,0	3,8	3,2	3,5	3,2	2,5
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,6	3,5	3,6	3,8	3,8	3,9	4,5	4,4	3,9	3,7	3,5	3,4	3,3
3	Veshje dhe këpucë	3,9	3,6	3,5	4,0	3,8	3,3	2,8	3,0	2,7	2,5	1,8	0,9	0,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	1,5	1,5	1,2	1,4	0,9	0,9	0,4	0,9	1,1	1,5	1,8	3,0	3,1
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	3,5	3,6	2,9	3,3	4,2	3,9	3,6	3,5	3,2	3,2	3,0	2,7	2,8
6	Shëndeti	1,4	1,1	1,2	1,1	1,1	0,9	0,6	0,6	0,5	0,5	0,6	0,4	0,4
7	Transporti	-3,1	-4,5	-5,3	-5,4	-2,8	-2,5	-2,2	-2,5	-2,6	-1,2	-0,5	-0,4	0,5
8	Komunikimi	0,6	0,8	0,8	0,8	1,2	1,2	1,2	1,5	1,5	1,6	1,6	1,5	1,2
9	Argëtim dhe kulturë	4,0	4,6	5,0	5,7	5,6	5,7	6,5	7,4	6,3	6,3	6,8	7,7	6,3
10	Shërbimi arsimor	2,2	0,9	0,7	0,8	0,8	0,9	0,9	0,9	0,9	0,9	0,9	0,8	0,7
11	Hotele, kafene dhe restorante	1,8	1,8	1,8	1,8	1,8	1,7	1,8	1,9	1,7	1,8	1,7	2,0	2,2
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	2,1	1,9	1,9	1,9	1,5	1,6	1,4	1,3	1,3	1,1	1,2	1,2	1,2

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	08-24	09-24	10-24	11-24	12-24	01-25	02-25	03-25	04-25	05-25	06-25	07-25	08-25
	Gjithsej	0,5	0,6	0,1	0,0	0,6	0,4	0,3	0,6	0,1	-0,3	-0,2	-0,1	0,3
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	1,0	1,4	0,3	-0,3	0,9	0,9	0,9	1,2	0,0	-1,3	-0,9	-1,0	0,3
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,4	0,1	0,3	0,2	1,1	0,2	0,6	0,2	0,0	0,0	0,0	0,2	0,3
3	Veshje dhe këpucë	0,6	0,5	0,4	0,6	0,3	-0,3	-0,5	0,1	-0,1	0,0	-0,3	-0,4	0,3
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,4	0,1	-0,2	0,3	0,1	0,0	-0,3	0,5	0,2	0,5	0,3	1,2	0,5
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,3	0,5	0,1	0,2	1,0	0,3	0,2	-0,1	0,0	0,4	0,0	-0,2	0,4
6	Shëndeti	0,1	0,0	0,1	-0,1	0,2	0,1	0,1	0,0	-0,1	0,1	0,0	-0,2	0,1
7	Transporti	-0,7	-0,1	-0,5	-0,5	0,6	0,0	0,1	0,1	0,0	0,3	0,3	0,1	0,2
8	Komunikimi	0,4	0,2	0,0	0,0	0,4	0,0	0,0	0,2	0,1	0,1	0,0	0,0	0,1
9	Argëtim dhe kulturë	1,8	1,9	0,4	-0,2	-0,1	0,2	0,9	1,3	0,0	0,6	0,5	0,3	0,5
10	Shërbimi arsimor	0,2	0,4	0,1	0,1	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,3	0,0	0,2	0,0	0,2	0,0	0,2	0,1	0,0	0,1	0,0	0,7	0,5
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,2	0,1	0,0	0,2	0,1	0,3	0,2	0,1	0,1	-0,1	0,1	0,1	0,1

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2023.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbledhen çmimet.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.